



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE – MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE – MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
Administrata Tatimore e Kosovës – Poreska Administracija Kosova – Tax Administration of Kosovo

Njoftim për Tatimpagues

Prishtinë: 10.07.2010, Administrata Tatimore e Kosovës, që nga muaji Mars 2010, ka njoftuar për fillimin e instalimit vullnetar të Pajisjeve Elektronike Fiskale (PEF), ndërsa nga muaji Prill 2010, ka njoftuar se të gjithë tatimpaguesit që kanë pikat e shitjes me para të gatshme, janë të obliguar të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale. ATK-ja, ka publikuar se cilat kategori (grupe) të tatimpaguesve do të përfshihen në fazën e parë dhe afatet për instalimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale.

Kërkesa e përcaktuar me ligj për të regjistruar transaksionet, nëpërmjet të regjistruarëve të Pajisjeve Elektronike Fiskale, dhe kërkesa për të lëshuar kuponin për mallrat dhe shërbimet që janë blerë, do të jetë në dobi të popullit të Kosovës, kjo përmirëson aftësinë e Administratës Tatimore, për tu siguruar që të gjithë tatimpaguesit i përmbushin obligimet e tyre tatimore dhe i raportojnë me saktësi të ardhurat e tyre.

Kjo do të thotë konkurrencë e drejtë në vendin e tregut dhe ndihmë për mbrojtjen e bizneseve të ndershme, prej atyre personave, të cilët përpiqen të shesin mallrat, apo shërbime pa paguar obligimet tatimore që dalin nga këto shitje.

ATK-ja, njofton se bizneset që do të përfshihen në fazën e dytë dhe afatet për instalimin e Pajisjeve Elektronike Fiskale, janë të përcaktuara si në vijim :

- 1) Bizneset me veprimtari Shërbime Profesionale Shëndetësore (*Ordinanca specialistike; laboratorë; spitale e të ngjashme,*) që veprojnë në Regjionet : Prishtina 1; Prishtina 2; Prizren; Gjakovë; Pejë; Mitrovicë; Gjilan; Ferizaj, dhe Njësisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, (NJTM), duhet të pajisen me Pajisje Elektronike Fiskale, më së largu deri me 30 Gusht 2010 .

Për informata tjera në lidhje me shtrirjen e projektit, mund ti gjeni në www.atk-ks.org në linkun Arkat Fiskale, dhe mund të kontaktoni zyrat regjionale të ATK-së.

Administrata Tatimore e Kosovës